



Trajtimi ne detaje i shpenzimeve te buxhetit e (versioni i shkurter- pjesa 3)

(Resource ID: 403)

Samantha Prior

samantha.prior(at)ul.ie

This teaching resource is allocated to following University:

UL - University of Limerick

Institution:

University of Limerick

<http://sustainicum.at/sq/modules/view/403.Trajtimi-ne-detaje-i-shpenzimeve-te-buxhetit-e-versioni-i-shkurter-pjesa-3>



Puna ne grup



**Me pak sesa 5
studente**



**Deri në 3 njësi
leksionesh**



Anglisht, Shqip

Burimi i mësimdhënies "Trajtimi në thellësi i shpenzimeve të buxhetit (Versioni i shkurtër – Pjesa 1, 2 dhe 3) është drafti i një burimi të mësimdhënies që është ndarë në 3 pjesë. Burimet e mësimdhënies u zhvilluan që të informonin studentët për vështirësitë që hasen kur krijohet një buxhet, për shembull: si e vendosni ju se kush meriton më shumë fonde? Studentët do të marrin shansin për të krijuar buxhetin e tyre ideal, debatojnë me shokët e klasës për harxhimet e zgjedhura, të shikojnë si menaxhohen buxhetet në nivel ndërkombëtar dhe së fundmi, do të marrin mundësinë për të punuar ngushtë me këshilltarë financiarë për të mësuar për tregun. Studentët do të mësojnë të shohin thellë shpenzimet publike dhe të prezantojnë gjetjet e tyre tek palët e

interesit. Grupi me kërkimin më të mirë do të ketë mundësinë të punojë në departamentin e financës për nja dy javë dhe të përfitojnë nga eksperiencia e tregut. Burimet e mësimdhënies do të inkorporohen por nuk janë të limituara në metodat e mëposhtme: - Të mësuarit me bazë problemin - Debat - Një problem, pikëpamje të ndryshme - Intervista - Mësimdhënia e rastit të studimit - Punë kërkimore - Diskutim - Prezantim Seti i mësimdhënies përshkruan tre burime mësimdhënieje të pavaruara, të cilat janë të skicuara të plotësohen njëra pas tjetrës, dhe këto përfshijnë: 1. Të mësuarin me bazë problemore - Buxheti ideal dhe debat 2. Një problem, pikëpamje të ndryshme - Buxhetet në vende të ndryshme 3. Intervistimi i palëve kryesore të interesit dhe kërkimorët në një zonë kryesore në buxhet Trajtimi i thellë në shpenzimet e buxhetit (Versioni i shkurtër - Pjesa 1, 2 dhe 3) bazohet (dhe paksa modifikohet) në Burimin e Mësimdhënies, "Hasja e transparencës e shpenzimeve publike përmes angazhimit të qytetarit". Burimi origjinal i mësimdhënies u nda për të lejuar lektorët të provojnë teknika të reja të mësimdhënies dhe i prezantojnë ato ngadalë si pjesë e setit të tyre të leksioneve. Këto burime të mësimdhënies synojnë të promovojnë stilet e ndryshme të mësimin në klasë, dhe shpresojnë të demonstrojnë se të mësuarit aktiv është një pjesë vitale e cdo klase.

Pjesa 3 – Intervistimi paleve kryesore te interesit dhe kerkimit per nje zone kryesore ne buxhet

Këshilltarët financiarë do të prezantojnë buxhetin e këtij viti në klasë dhe më pas klasa do të intervistojë këshilltarët financiarë për shpërndarjen e parave në buxhetin që ata kishin krijuar dhe vështirësitë që ata përballen. Studentët do të punojnë në grupe me tre student, secilit do t'i jepet një seksion i ndryshëm buxheti nga vitet e kaluara dhe është detyra e tyre të identifikojnë zhvillimet në buxhet. (Disa gabime mund të shtohen me qëllim të shikojnë nëse ata do të arrijnë të identifikojnë gabimet.) Pasi kanë analizuar buxhetin, ata do të prezantojnë gjetjet tek palët e interesit dhe grupi fitues do të marrë mundësinë të punojë në departamentin e financës për rreth dy javë.

Teksti kryesor

Shpenzimet publike dhe buxheti i shtetit janë shumë të rëndësishme dhe në interes të publikut. Është e rëndësishme t'u sigurohet qytetarëve akses në financat dhe fondet publike, ku treguesit janë lehtësisht të aksesueshëm, të shpërndarë, dhe të përdorur në një mënyrë efektive. Duke kontrolluar shpenzimet, parregullsitë dhe mashtrimet, mundësia e korrupsionit mund të evitohet. Ky burim mësimdhënieje synon të angazhojë studentët në procesin e shpenzimeve publike dhe i lejon ata të kuptonë parregullsitë dhe abuzimet që ndodhin gjatë procesit të shpërndarjes së buxhetit.

Një element i rëndësishëm i qeverisë dhe për të cilin publiku shqetësohet është transparenca e shpenzimeve në buxhetin e shtetit. Mënyra më e mirë për të promovuar besueshmërinë është përmes rritjes së transparencës të financave publike, cilësisë së informacionit të prodhuar dhe shpërndarë, besueshmërisë dhe pjesëmarrjes nga komunitetet lokale, dhe gjithashtu duke rritur presionin pozitiv tek zyrtarët e zgjedhur për të përmirësuar shërbimet që u ofrohen qytetarëve. Transparenca sesi shpenzohen paratë e taksapaguesve në grantet e qeverisë, shërbimet administrative dhe investimet në infrastrukturë është e varfër. Liria e informacionit për qytetarët dhe grupe të tjera të interesit si media ende mbeten një çështje e madhe të adresohet me kujdes.

Në këtë mënyrë, studentët duhet të bëjnë një vizitë në terren tek zyrtarët e qeverisë lokale për të analizuar nëse kishte parregullsi gjatë shpërndarjes së buxhetut ose nëse ishin hasur shpenzime. Studentët do të angazhohen në vlerësimin e të dhënave dhe kërkimit, si dhe në procesin e intervistimit të zyrtarëve kryesorë. Ata do të kenë mundësinë e hetimit të një teme të zgjedhur prej tyre (për shembull. Shpenzimet lokale publike, shpenzimet qëndrore publike, tenderat/ përzgjedhja, kostot e udhëtimeve të zyrtarëve, etj.) Tema së bashku me kërkimin do të bihet dakort në bashkëpunim me lektorët dhe do të prezantohet tek palët e interesit kryesore sapo vlerësimi i buxhetit të ketë marrë pjesë.

Mjetet e mësimdhënies



Mini-projekt për studentët

Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Keshilltaret financiere dhe zyrtaret e qeverise jane pjese e burimeve te mesimdhenies si partnere aktive. Studentet kane mundesine te hyjne ne kontakt direkt me ata te punesuar qe jane te perfshire ne menaxhimin e financave publike dhe te mesojne me shume per sfidat qe perballen ne shperndarjen e raporteve per ceshtjet e buxhetit

Pika e forte

- Pervoje e te mesuarit aktiv per studentet
- Te mesojne te punojne ne grup
- Te kuptojne rendesine e shpenzimeve financiare
- Studentet mesojne te zhvillojne mjetet e ndikimit te zyrtareve qeveritare dhe te jene pjese e shoqerise civile.
- Palet e interesit perfitojne nga perceptimet e te kuptuarit publik dhe pikepmaja e tyre sesi te ndryshojne gjerat.
- Studentet mendojne per pergjegjesine e tyre ne kontekstin e puneve publike.

Pika e dobët

- Ceshtjet me mungese bashkepunimi nga zyrtaret publike
- Mungesa e informacionit te publikuar per financat publike

Rezultatet e të mësuarit

- Te intervistojte keshilltaret financiere
- Te analizoje seksionin e tyre te zgjedhur te buxhetit
- Te prezantoje gjetjete e buxhetit tek palet e interesit
- Te vleresoje rolin e rendesishem qe luan buxheti ne qendrueshmerine ekonomike te nje vendi

Lidhja për qëndrueshmëri

- Te rriti ndergjegjesimin publik per shpenzimet publike
- Nje publik i informuar do te ushtroje presion te vazhdueshem pozitiv tek zyrtaret e zgjedhur per te permiresuar sherimet publike, e cila eshte nje proces i vazhdueshem.

Njohuri paraprake

Asnje lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

Përpjekjet e përgatitjes

Mesatare

Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

Rregullimi i vizitave nga keshillaret financiere

Aksesi

Free

Gjykimi / vlerësimi

Dorezimi dhe prezantimi i gjetjeve të tyre të kerkimit nga buxheti

Kreditim/Çertifikatë

Kredit për dorezimin dhe prezantimin e gjetjeve të kerkimit të tyre nga buxheti.

Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.